



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1113/3 Prot

Tiranë, më 6/8/2019

VENDIM

Nr. 26, datë 6.8.2019

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1113 Prot., datë 17.07.2019, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik Institutit të Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Me anë të shkresës datë 21.06.2019, z. _____, ka kërkuar nga Autoriteti Publik, dokumentin si më poshtë vijon:

- *Kopje të projektit për restaurimin e Këmbanares së Kishës së "Shën Kollit", në Manastirin e Mesopotamit, Sarandë, në kuadër të programit MileSTONES II.*

Me shkresën nr.1327/3 prot., datë 08.07.2019, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar me argumentin se: "*Kufizohet nga neni 17, pika 1, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe neni 25, pika 1, shkronja b) dhe neni 46 pika 4 e Ligjit nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të".*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, z. _____ ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me Urdhrin nr. 218 datë 24.07.2019 vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që janë bërë pengesë për vënien në dispozicion të dokumentit të kërkuar.

Gjatë inspektimit koordinatorja e të drejtës për informim pranë Autoritetit Publik sqaroi se, me shkresën nr.1327/1 prot., datë 01.07.2019, i ka kërkuar bashkëautorit të projektit miratimin për vënien në dispozicion të kërkuarit të kopjes së projektit.

Ky i fundit, me emailin e datës 08.07.2019, administruar pranë Autoritetit Publik me nr.1327/2 prot., datë 08.07.2019, nuk ka miratuar vënien në dispozicion të kërkuarit të kopjes së projektit.

Autoriteti Publik ka argumentuar se ky informacion i nënshtrohet kufizimit të nenit 17, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas së cilit: "*E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: ...c) të drejtën e autorit*", si dhe ka referuar ligjin nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", si argument për refuzimin e vënies në dispozicion të dokumentit të kërkuar.

Pas shqyrtimit të ankimit, inspektimit të ushtruar, si dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se, arsyetimi i Autoritetit Publik për refuzimin e vënies në dispozicion të dokumentit të kërkuar me argumentin se një gjë e tillë kufizohet nga e drejta për informim sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", si dhe ndalohej nga dispozitat e Ligjit nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", nuk është i drejtë.

Kjo për arsye se, bazuar në nenin 17, pika 1 gërma c), parashikohet ndër të tjera se: "*...Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënie të tij*". Duke qenë se objekti për të cilin është miratuar dokumenti (projekti) është shpallur monument kulture, interesi publik që karakterizon ndërhyrjet arkitekturore në të, është i lartë.

Dokumenti i kërkuar është hartuar nga Autoriteti Publik në bashkëpunim me subjektin privat, në kuadër të veprimtarisë institucionale të Autoritetit dhe për rrjedhojë publikimi i tij duhet të bëhet edhe në funksion të transparencës.

Në lidhje me argumentin e dhënë nga Autoriteti Publik se, dispozitat e Ligjit nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", ndalojnë publikimin e dokumentit të kërkuar, sqarojmë se në parim kërkesa e ankuesit për t'u informuar nuk çënon apo zhvesh autorin nga të drejtat e njohura me ligjin e posaçëm si dhe mekanizmat që ky ligj i vë në dispozicion autorit dhe/ose mbajtësit të së drejtës për të mbrojtur atë.

Projekti i përmirësimit struktural, për kishën e Shën Kollit, përbën në vetvete një akt të miratuar në kuadër të një procedure administrative të Autoritetit Publik. Në këtë optikë, në referencë të ligjit nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", në nenin 38 pika 2 e të cilit parashikohet ndër të tjera se: "*Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore*

Materiale ka kompetencë: a) të licencojë subjektet, personat fizikë apo juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore, në projektim, zbatim, mbikëqyrje, kolaudim, vlerësim, të aktiviteteve arkeologjike, të arkeologjisë së shpëtimit; b) të miratojë projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim; c) të miratojë lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme”, rezulton se projekti është produkt i një procesi të mirëfilltë administrativ.

Në vijim të këtij arsytimi, vlen të theksohet se sikurse parashikohet në nenin 67 të Ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” bashkëprojektuesi ka kryer një procedurë të komisionuar nga Autoriteti Publik, e cila duhet të kryhej nga ky i fundit, por që për shkak të njohurive të posaçme që kërkon, është hartuar në bashkëpunim me të në cilësinë e subjektit të licencuar.

Sa më sipër subjekti i licencuar i ka kaluar Autoritetit Publik në cilësinë e porositësit të drejtën e shfrytëzimit të veprës së tij, në përputhje me nenin 48 të Ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

Në bazë të nenit 78 të Ligjit të sipër përmendur, veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi në kuadër të një procedure administrative dhe për rrjedhojë kufizimet e pretenduara nga Autoriteti Publik nuk gjejnë zbatim.

Në përfundim, rezulton se për sa kohë bashkëprojektues është institucioni publik dhe projekti është regjistruar pranë autoritetit publik dhe administrohet prej tij, ky dokument përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’.

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1113 Prot., datë 17.07.2019 të z. _____, ndaj Autoritetit Publik Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, konkretisht: - *Kopje të projektit për restaurimin e Këmbanares së Kishës së “Shën Kollit”, në Mesopotam, Sarandë, në kuadër të programit MileSTONE II, brenda datës 14 . 8 .2019.*
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 6 . 8 .2019.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

